

LIGJI Nr. 06/L -023

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-034 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT, I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN Nr. 04/L-115 DHE ME LIGJIN Nr. 05/L-080

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-034 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT, I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN Nr. 04/L-115 DHE ME LIGJIN Nr. 05/L-080

Neni 1

Qëllimi

Me anë të këtij ligji ndryshohet dhe plotësohet Ligji Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 19, 21 shtator 2011), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-115 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 25, 7 shtator 2012) dhe me Ligjin Nr. 05/L-080 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 38, 24 dhjetor 2015) me qëllim të lejitimit të investimit të mjeteve të privatizimit në letrat me vlerë, me qëllim të rregullimit të trajtimit të “fondeve të mbetura”, trajtimit të “fondeve të përkohshme” si të hyra në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës dhe rregullimit të proceseve operative të Agjencisë.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e këtij ligji janë të obligueshme për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës që i nënshtrohen zbatimit të këtij ligji.

Neni 3

Përkufizimet

1. **Ligji bazik** – nënkupton Ligjin Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-115 dhe me Ligjin Nr. 05/L-080.

2. Shprehjet tjera të përdorura kanë kuptimin e përcaktuar në ligjin bazik.

Neni 4

1. Neni 2, paragrafi 2, nën paragrafët 2.1 dhe 2.4, i ligjit bazik, ndryshohen si në vijim:

2.1. deri në shitjen ose zgjidhjen në mënyrë tjetër sipas këtij ligji, mban dhe administron secilën ndërmarrje dhe asete në mirëbesim dhe në të mirë të pronarëve dhe kreditorëve të tyre, në përputhje me këtë ligj dhe legjisllacionit në fuqi. Fondet e Përkohshme, ashtu

siç definohe në këtë ligj, do të barten përkohësisht në një llogari të veçantë bankare në Thesarin e Kosovës dhe llogariten që janë pjesë e Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës;

2.4. në mënyrën dhe masën e paraparë në këtë ligj, përmbush pretendimet e vlefshme dhe të dorëzuara me kohë të kreditorëve dhe pronarëve lidhur me një ndërmarrje apo asetë të caktuara, nga mjetet e realizuara nga shitja, transferimi, likuidimi ose zgjidhja tjetër e ndërmarrjes ose asetit; me ç'rast të gjitha këto të ardhura me përjashtim të Fondeve Tepricë, Fondeve të Mbetura dhe Fondeve të Përkohshme do të mbahen në mirëbesim për pronarët dhe kreditorët dhe do të ruhen nga Agjencia;

2. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 2.6. ri numërohet dhe bëhet me numër rendor 2.8.

3. Neni 2 i ligjit bazik, pas nënparagrafit 2.5., shtohen nënparagrafët me numër rendor 2.6. dhe 2.7., me tekstin si në vijim:

2.6. Pas përmbushjes së vlefshme të kërkesave të kreditorëve në proces të likuidimit sipas Shtojcës së ligjit bazik, fondet e mbetura, nëse ka të tilla, barten nga Agjencia në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës, në një llogari të veçantë në Thesarin e Kosovës, dhe përdoren për investime që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin afatgjatë ekonomik të vendit. Në rast se Fondi në Mirëbesim i Ndërmarrjes Shoqërore përkatëse, pas bartjes së fondeve të mbetura në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës, është i pamjaftueshëm për përmbushjen e të gjitha kërkesave kreditore të cilat përfundimisht vendosen si të vlefshme pas procesit të ankesave në Dhomën e Posaçme, Agjencia e njofton Qeverinë për këtë. Qeveria brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike, ia kthen Agjencisë shumë e nevojshme nga fondet e mbetura, të cilat Agjencia i përdorë për përmbushjen e kërkesave kreditore në procesin e likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore përkatëse.

2.7. Pas llogaritjes së shumës së nevojshme për përmbushjen e vendimeve të vlefshme të kërkesave kreditore në proces të likuidimit, sipas Shtojcës së ligjit bazik dhe pas llogaritjes së fondeve të nevojshme për aktivitetet dhe proceset ligjore tjera të Agjencisë, Fondet e Përkohshme, nëse ka të tilla, barten nga Agjencia në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës, në një llogari të veçantë në Thesarin e Kosovës, të cilat fonde të përkohshme përdoren për investime që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin afatgjatë ekonomik të vendit. Në rast se fondi në mirëbesim i Ndërmarrjes Shoqërore përkatëse, pas transferimit të fondeve të përkohshme në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës, është i pamjaftueshëm për përmbushjen e të gjitha kërkesave kreditore të cilat përfundimisht vendosen si të vlefshme pas procesit të ankesave në Dhomën e Posaçme apo për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve tjera të Agjencisë sipas ligjit bazik, Agjencia e njofton Qeverinë për këtë. Qeveria brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike, ia kthen Agjencisë shumë e nevojshme nga fondet e përkohshme, të cilat Agjencia i përdorë për përmbushjen e kërkesave kreditore në procesin e likuidimit dhe mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve tjera të Agjencisë, që ndërlihen me Ndërmarrjen Shoqërore përkatëse.

Neni 5

1. Neni 3 i ligjit bazik, nën paragrafi 1.23, ndryshohet me tekstin si në vijim:

1.23. Fonde Tepricë - të ardhurat që mbahen në mirëbesim nga Agjencia të përcaktuara në mënyrë të arsyeshme, në pajtim me nenin 19 të ligjit bazik, që nuk janë të nevojshme për përmbushjen e pretendimeve që janë parashtruar brenda afatit kohor nga kreditorët

dhe pronarët përkatës.

2. Neni 3 i ligjit bazik, pas nën paragrafit 1.27, shtohen nën paragrafët me numër rendor 1.28 dhe 1.29 me tekstin si në vijim:

1.28. Fondet e Mbetura - të ardhurat që mbahen në mirëbesim nga Agjencia të përcaktuara në mënyrë të arsyeshme, që mbesin pas përmbushjes së obligimeve të parapara në nenin 40 dhe 41 të shtojcës së ligjit bazik.

1.29. Fondet e Përkohshme - të ardhurat e përcaktuara nga Agjencia në mënyrë të arsyeshme, që mbesin pas llogaritjes së përmbushjes së obligimeve të parapara në nenin 2.7 të këtij ligji dhe neneve 40, 41 dhe 42 të shtojcës së ligjit bazik.

Neni 6

Pas nenit 6 të ligjit bazik, shtohet neni me numrin rendor 6/A, me tekstin si në vijim:

Neni 6/A

Kompensimi për pronat e shpronësuara të Ndërmarrjeve Shoqërore

1. Pavarësisht nga neni 11 paragrafi 8 si dhe neni 26 paragrafi 1 i Ligjit nr.03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Qeveria e Kosovës brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike merr për obligim që lidhur me shpronësimet e pronave të Ndërmarrjeve Shoqërore nga vlera e përgjithshme e shpronësimit, t'i kompensoj Agjencisë shumat si në vijim:

1.1. Njëzet përqind (20%) e vlerës së pronës së shpronësuar, për të kompensuar punëtorët e kualifikuar të Ndërmarrjeve Shoqërore në pajtim me nenin 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/45.

2. Vendimi për transferin pronësor të pronës së shpronësuar në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës merret nga Bordi i Drejtorëve të Agjencisë, pasi të plotësohen obligimet financiare të Qeverisë të përcaktuara sipas nënparagrafit 1.1. të këtij neni.

3. Në rast se fondi në mirëbesim i Ndërmarrjes Shoqërore përkatëse, është i pamjaftueshëm për përmbushjen e të gjitha kërkesave kreditore të cilat përfundimisht vendosen si të vlefshme apo për mbulimin e shpenzimeve të parapara në paragrafët 1.1 deri 1.3 të nenit 40 të shtojcës së ligjit bazik, Agjencia e njofton Qeverinë për këtë dhe Qeveria, respektivisht Ministria e Financave brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike ia transferon Agjencisë shumën e nevojshme për përmbushjen e kërkesave kreditore në procesin e likuidimit apo për mbulimin e shpenzimeve të parapara në paragrafët 1.1 deri 1.3 të nenit 40 të shtojcës së ligjit bazik, por jo më shumë se sa vlera e pronës së shpronësuar.

4. Në rast se ka fonde të mbetura nga vlera e përgjithshme e shpronësimit pas përmbushjes së të gjitha detyrimeve sipas këtij neni, atëherë ato fonde do të trajtohen në pajtim me nenin 4, paragrafin 3 të këtij ligji.

5 Ky nen vlen për shpronësimet e pronave të Ndërmarrjeve Shoqërore që kanë filluar

dhe janë në procedurë të kompensimit dhe për pronat e Ndërmarrjeve Shoqërore në të ardhmen.

Neni 7

Neni 11 i ligjit bazik, pas paragrafit 5 shtohet një paragraf i ri me numrin rendor 6, me tekstin si në vijim:

6. Struktura e përgjithshme organizative dhe kompensimi i personelit të Agjencisë rregullohet sipas ligjit bazik dhe rregulloreve të nxjerra nga Bordi i Drejtorëve.

Neni 8

Neni 12 i ligjit bazik, ndryshohet si në vijim:

Neni 12 Përbërja e Bordit

1. Bordi përbëhet nga tetë (8) Drejtorë.
2. Kuvendi i Kosovës me propozim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, emëron Drejtorët e Bordit, duke përfshirë një përfaqësues nga komunitetet jo shumicë si dhe një përfaqësues nga konfederata sindikale e punëtorëve.
3. Kuvendi i Kosovës, me propozim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nga radhët e anëtarëve të Bordit cakton Kryesuesin e Bordit.
4. Bordi emëron për zëvendës kryesues të Bordit, njërin prej anëtarëve të tij.
5. Drejtorët shërbejnë në Bord në cilësi personale dhe marrin pjesë personalisht në takimet e Bordit.
6. Asnjë person nuk mund të emërohet ose të mbetet Drejtor nëse:
 - 6.1. është dënuar për kryerje të ndonjë vepre penale;
 - 6.2. është përjashtuar ose suspenduar nga ushtrimi i mëtutjeshëm i profesionit të tij për shkak të shkeljeve të rënda profesionale në pajtim me legjisllacionin në fuqi;
 - 6.3. ka interes apo pretendim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në apo kundër një ndërmarrje ose në një person apo subjekt i cili pretendon apo pohon një interes apo pretendim; dhe
 - 6.4. ka interesa ose angazhohet në veprimtari të cilat janë në kundërshtim me përgjegjësitë e tij sipas nenit 15 të ligjit bazik.
7. Për të pasur të drejtën e zgjedhjes si Drejtor, personi duhet të ketë së paku pesë (5)

vite përvojë pune në njërin nga fushat në vijim: administratë publike, drejtësi, financa, ekonomi si dhe punë menaxheriale.

8. Bordi emëron Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, i cili nuk do të jetë anëtar i Bordit. Për emërimin, shkarkimin ose ndryshimin e kushteve të referimit të Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit kërkohen së paku pesë (5) vota pozitive të Bordit.

9. Drejtori menaxhues dhe dy zëvendës drejtorët menaxhues nuk janë anëtarë të Bordit.

Neni 9

Neni 13, paragrafi 1 i ligjit bazik ndryshohet, me tekstin si në vijim:

1. Kryesuesi, zëvendëskryesuesi dhe drejtorët tjerë të Bordit emërohen me mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat. Drejtori i Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, emërohet me mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Ky paragraf zbatohet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 10

Neni 14, paragrafi 7, i ligjit bazik ndryshohet si në vijim:

7. Për vendimet të cilat duhet të merren sipas nenit 15 nevojitet shumica e kualifikuar, vendimi do të merret me së paku pesë (5) vota pozitive. Bordi i Drejtorëve mund të përcaktoj me rregullore të veçantë se cilat vendime tjera të Bordit sipas ligjit bazik do të merren me shumicë të kualifikuar.

Neni 11

Neni 15, paragrafi 2, nën paragrafi 2.3. dhe nën paragrafi 2.12 ndryshohen si në vijim:

2.3. emërimi apo shkarkimi i Drejtorit Menaxhues, Zëvendës drejtorit Menaxhues ose ndonjë zyrtari tjetër, emërimi i të cilëve është rezervuar për Bordin;

2.12. shitja ose transferi i një pjese ose i të gjitha aksioneve të një korporate të krijuar sipas nenit 8 të ligjit bazik si dhe shitja e pronave të Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat janë vendosur në likuidim sipas nenit 9 të ligjit bazik.

Neni 12

Neni 18, paragrafi 3, ndryshohet si në vijim:

3. Asetet tjera të ndërmarrjeve që administrohen nga Agjencia do të mbahen në mirëbesim veçmas nga asetet e Agjencisë.

Neni 13

Neni 19, paragrafi 2 fshihet nga teksti i ligjit bazik.

Neni 14

Pas nenit 19 të ligjit bazik, shtohen nenet 19/A dhe 19/B me tekstin si në vijim:

Neni 19/A

Kthimi i fondeve të përkohshme nga Qeveria

1. Në rastet e parapara në nenin 4, paragrafin 3.2.7, të këtij ligji, Qeveria e Kosovës, në emër të Republikës së Kosovës, garanton dhe e ka obligim të pakushtëzuar të Republikës së Kosovës për t'ia kthyer fondet e përkohshme Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike kur të dërgohet kërkesa me shkrim e Agjencisë në Ministrinë e Financave;

2. Kërkesat e Agjencisë drejtuar Ministrisë së Financave për kthimin e fondeve të përkohshme e përbëjnë prioritetin e parë kundër llogarisë së përgjithshme të Thesarit dhe këto fonde të përkohshme nuk do t'i nënshtrohen asnjë ankese apo pretendimi tjetër nga cilado palë. Kthimi i fondeve të përkohshme në Agjenci e ka prioritetin më të lartë në listën e prioritetëve të pagesave të parapara në nenin 38.3 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet nr.03/L-221, nr.04/L-116, nr. 04/L-194, nr. 05/L-063 dhe nr. 05/L-007, (tash e tutje LMFPF).

Neni 19 B

Investimi i fondeve në mirëbesim

1. Përveç asaj që është paraparë në këtë ligj për fondet tepricë, fondet e mbetura dhe fondet e përkohshme, të ardhurat e mbledhura nga Agjencia si rezultat i aktiviteteve të saj sipas ligjit bazik dhe të cilat mbahen në mirëbesim mund të investohen në instrumentet në vijim:

1.1. Llogari rrjedhëse që paguan interes apo depozitë të afatizuar në Bankën Qendrore të Kosovës; dhe

1.2. Letra me vlerë të borxhit të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 15

Neni 21 i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si në vijim:

Neni 21

Financimi: të hyrat e dedikuara

1. Agjencia Financohet nga të Hyrat e Dedikuara në pajtim me dispozitat e LMFPF të zbatueshme për agjencitë e pavarura.

2. Të gjitha të ardhurat e Agjencisë do të jenë të ardhura të dedikuara të Agjencisë sipas nenit 64 të LMFPF-së. Përveç kësaj, pesë përqind (5%) e të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shitje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo

aset, pavarësisht nëse është bërë nga Agjencia apo paraardhësja e saj, do të jetë tarifë administrative e Agjencisë për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative; dhe ajo tarifë do të jetë pjesë e të ardhurave të dedikuara të Agjencisë. Agjencia në baza vjetore i transferon dhe depoziton të gjitha ato të ardhura nga tarifa në Fondin e Konsoliduar të Kosovës, në pajtim me rregullat në fuqi të LMFPP-së. Thesari dhe Ministria e Financave sigurojnë që ato fonde të vendosen dhe mbahen në llogarinë e dedikuar të të ardhurave të Agjencisë.

3. Të gjitha të ardhurat e dedikuara të agjencisë i nënshtrohen procesit të përvetësimit buxhetor të krijuar nga LMFPP për agjencitë e pavarura. Çdo e hyrë e tillë e dedikuar që nuk është përvetësuar nga Agjencia për tu shpenzuar gjatë vitit kalendarik sipas Ligjit përkatës të përvetësimit vjetor, mbahet në llogarinë e dedikuar të të ardhurave të Agjencisë dhe mund të shfrytëzohet vetëm për bërë përvetësime në të ardhmen për Agjencinë.

4. Agjencia mund të pranojë edhe financim nga palët e treta, me kusht që dhënia dhe marrja e financave të tilla të bëhet në pajtim me LMFPP-në dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 16

Neni 22 i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si në vijim:

Neni 22

Trajtimi i tatimeve

1. Të ardhurat dhe prona e Agjencisë janë të përjashtuara nga tatimi, me kusht që përjashtimi i tillë të mos vlej për ndërmarrjet, korporatat dhe asetet e tjera të administruara nga Agjencia si agjenci mirëbesimi.

2. Transferi i asetëve dhe shitja e aksioneve në pajtim me nenin 8 dhe nenin 9 të ligjit bazik nuk i nënshtrohet tatimit mbi vlerën e shtuar.

Neni 17

Neni 2, paragrafi 1.11 i shtojcës së ligjit bazik, ndryshohet si në vijim:

1.11. **Ligji për AKP-në**, do të thotë Ligji nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115 dhe me Ligjin nr.05/L-080, të cilit i është bashkangjitur kjo shtojcë.

Neni 18

1. Neni 7 i Shtojcës së ligjit bazik, nën-paragrafi 2.6.3 ndryshohet me tekstin si në vijim:

2.6.3. përfshin një deklaratë të qartë me shkronja të theksuara se të gjithë Personat që pretendojnë të kenë kërkesa apo interesa në apo ndaj ndërmarrjes duhet të veprojnë në pajtueshmëri me kërkesat e saktësuara në njoftim dhe të përsërisin dëshminë e kërkesës apo të interesit; pavarësisht nëse më herët e kanë parashtruar një kërkesë të tillë apo informuar Gjykatën, Agjencinë apo pararendësin e Agjencisë (Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit) në lidhje me të;

2. Neni 7 i shtojcës së ligjit bazik, paragrafi 5 ndryshohet si në vijim:

5. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas publikimit fillestar të Njoftimit për likuidim, Autoriteti i Likuidimit publikon përsëri njoftimin në pajtim me Dispozitat për shpallje. Për të shmangur dyshime, ky publikim i Njoftimit për likuidim nuk ka ndikim në datën dhe kohën e Afatit për parashtrimin e kërkesave, i cili mbetet ai që është saktësuar në njoftimin fillestar.

Neni 19

1. Neni 13 i Shtojcës së ligjit bazik, paragrafi 2 fshihet nga teksti i ligjit.

2. Neni 13 i Shtojcës së ligjit bazik, paragrafi 3, ri numërohet me numrin rendor 2.

3. Neni 13 i Shtojcës së ligjit bazik, shtohet paragraf i ri me numë rendor 3, me tekstin si në vijim:

3. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, Bordi mund të emëroj anëtarët e Autoritetit të Likuidimit nga radhët e personelit të Agjencisë, në rastet kur administrimi i ndërmarrjes në likuidim rrezikohet në mungesë të angazhimit të Ofruesve të Shërbimeve Profesionale.

Neni 20

Neni 16 i Shtojcës së ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si në vijim:

Neni 16

Pagesa e Ofruesve të Shërbimeve Profesionale dhe shpenzimeve tjera të likuidimit

1. Tarifat dhe shpenzimet e Ofruesit të Shërbimeve Profesionale në procesin e likuidimit dhe kostot e procesit të likuidimit të parapara në paragrafët 1.1 deri 1.3 të nenit 40 të shtojcës së ligjit bazik do të paguhet nga llogaritë e likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore përkatëse.

2. Në rast se nuk ka fonde të mjaftueshme nga llogaritë e likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore përkatëse për të mbuluar kostot e parapara në paragrafin 1.1 dhe paragrafin 1.3 të nenit 40 të shtojcës së ligjit bazik, atëherë këto kosto do të mbulohen nga tarifa administrative e Agjencisë.

Neni 21

Neni 18 i Shtojcës së ligjit bazik, nën paragrafi 1.4 ndryshohet me tekstin si në vijim:

1.4. me miratimin paraprak të Bordit, shitjen apo zgjidhjen në mënyra tjera e asetit(ve) të ndërmarrjes përmes tenderit publik konkurrues (i cili do të drejtohet nga Agjencia), apo pas negociatave direkte bazuar në aktet nënligjore të miratuara nga Bordi i Drejtorëve, përfshirë shitjen e këtyre aseteve të spastruara nga të gjithë pengjet dhe interesat.

Neni 22

Neni 19 i Shtojcës së ligjit bazik, paragrafi 6 ndryshohet me tekstin si në vijim:

6. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas datës së parë të publikimit të Njoftimit për Likuidim, Autoriteti i Likuidimit paraqet njoftim formal në pajtim me nenin 7 dhe 10 të Shtojcës së ligjit bazik në gjykatat përkatëse, Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve Kosovare, Regjistrin e Pengjeve të Kosovës, Regjistrin e Hipotekave në Kosovë, Agjencinë Kadastrale të Kosovës, bankën(at) e ndërmarrjes, Administratën Tatimore, Ofruesit e Shërbimeve Publike në nivel Qendror dhe Lokal. Këto organe janë përgjegjëse për të siguruar se kopja e atij njoftimi futet në dosje dhe regjistra të mbajtur nga ta në lidhje me ndërmarrjen apo asetet e saj. Ky njoftim do të përfshin referencë në këtë paragraf (6) dhe obligimin e institucionit në fjalë.

Neni 23

1. Neni 23 i shtojcës së ligjit bazik, nën paragrafi 1.1. ndryshohet me tekstin si në vijim:

1.1. emrin, adresën dhe informatat tjera të kontaktit të kreditorit të supozuar, në të kundërtën do të konsiderohet si e papranueshme dhe si e tillë nuk do të hyjë për shqyrtim të mëtutjeshëm në proces të likuidimit;

2. Neni 23 i shtojcës së ligjit bazik, nën paragrafi 2.1. ndryshohet me tekstin si në vijim:

2.1. emrin, adresën dhe informatat tjera të kontaktit të bartësit të supozuar të interesit, në të kundërtën do të konsiderohet si e papranueshme dhe si e tillë nuk do të hyjë për shqyrtim të mëtutjeshëm në proces të likuidimit;

Neni 24

Neni 36 i shtojcës së ligjit, paragrafi 1, ndryshohet me tekstin si në vijim:

1. Pas përcaktimit të pranueshmërisë së kërkesave të ndërlidhura me nenin 23.1.1 dhe 23.2.1 të shtojcës së këtij ligji, Autoriteti i Likuidimit merr në shqyrtim dhe refuzon, tërësisht apo pjesërisht, vlefshmërinë meritore të Kërkesave apo interesit të pretenduar të kapitalit apo pronësisë nëse refuzimi i tillë obligohet apo lejohet sipas këtij ligji apo elementeve tjera të ligjeve të Kosovës në fuqi apo me urdhër të Gjykatës.

Neni 25

Neni 42 i shtojcës së ligjit bazik ndryshohet me tekstin si në vijim:

Neni 42

Fondet e rezervuara

1. Me aprovim të Bordit, fondet likuide, paratë apo asetet e tjera mund të ndahen nga Autoriteti i Likuidimit në llogari të ndarë të dorëzarisë të mbajtur nga Agjencia për përmbushje të:

1.1. Kërkesave që janë në kontestim dhe që ende nuk janë zgjidhur nga Gjykata;

1.2. Kërkesave për pagesa që janë subjekt i shpengimit për të cilin duhet të dorëzohen dokumentet, identifikimet apo kuponët, përfshirë letrat me vlerë, obligacionet, apo instrumente të ngjashme;

1.3. Shpenzimet e ardhshme në lidhje me mirëmbajtjen e pronës apo asetëve të caktuara apo të ndërmarrjes,dhe

1.4. Kërkesat e ardhshme të cilat do të paraqiten me siguri, por që në kohën e Afatit për Parashtrimin e Kërkesave nuk ishin të konstatueshme.

2. Përjashtimisht nga dispozitat e parapara në këtë nen, Agjencia mund të llogaritë këto fonde të dorëzansë si pjesë përbërëse e Fondeve të Përkohshme të cilat do të trajtohen sipas dispozitave të këtij ligji, me kusht që Agjencia të mbaj në dorëzani njëzet e pesë përqind (25%) të shumë së vlerës së ankesave të dorëzuara në Dhomën e Posaçme ndaj vendimeve të Autoritetit të Likuidimit për kërkesat kreditore ndaj Ndërmarrjes Shoqërore.

Neni 26

Neni 43 i shtojcës së ligjit bazik, paragrafët 1 dhe 3 ndryshohen me tekstin si në vijim:

1. Autoriteti i Likuidimit, pas përfundimit të plotë apo përfundimit substancial të realizimit të pronës së Ndërmarrjes sipas likuidimit, apo pas mbylljes së rastit të Likuidimit, ia parashtron për informim raportin përfundimtar Bordit të Drejtorëve, para se të dorëzohet ky raport në Gjykatë nga Autoriteti i Likuidimit.

3. Autoriteti i Likuidimit brenda pesë (5) ditëve do të shpall në faqen zyrtare të internetit të Agjensisë, Raportin Përfundimtar të aprovuar nga Gjykata për mbylljen e rastit të likuidimit të ndërmarrjes.

Neni 27

Neni 49 i shtojcës së ligjit, paragrafi 1 ndryshohet me tekstin si në vijim:

1. Të gjitha njoftimet formale sipas shtojcës së ligjit bazik publikohen, së paku, si në vijim:

Neni 28

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 06/L -023

30 mars 2018

Shpallur me dekretin Nr. DL-017-2018, datë 20.04.2018 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi